



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
OSLUKA JE PRAVNOSHAZNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ / UROSEVAC

1.

*ME  
Fana*  
15 - 05 - 2018

P.nr.236/2018

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-** DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL, gjyqtari Adem Shabani, me bashkëpunëtoren profesionale Mimoza Shabani, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED] nga Ferizaj, me vendbanim në rrugën [REDACTED] i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj- Departamenit i Përgjithshëm PP/II.nr.323-1/18 të datës 05.02.2018, përshkak të veprës penale Sulmi nga neni 187 par.1 të KPRK-së duke vodosur rreth kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, më dt.10.04.2018 solli:

#### A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj Ferizaj -Departamenit i Përgjithshëm PP/II.nr.323-1/18 të datës 05.02.2018, dhe gjykata jep këtë:

#### URDHËR NDËSHKIMOR

Të akuzuari [REDACTED] nga Ferizaj,,me vendbanim në rrugën [REDACTED] [REDACTED], lindur me datë, [REDACTED] nga i ati [REDACTED], dhe e ëma [REDACTED], e gjinisë [REDACTED] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personale të letërnjoftimit [REDACTED] mbrohet në liri,

#### ËSHTË FAJTOR

**Sepse** - me datën 14.01.2017, rrethë orës 15:50, në ëmbëltoren [REDACTED], rruga "Medelin Olbright", në Ferizaj, për shkak të një mosmarrëveshje të atëçastshme, mes të pandehurit dhe të dëmtuarës [REDACTED], me dashje e ka përdor forcën ndaj të dëmtuarës, në atë mënyrë që e ka sulmuar fizikisht duke e goditur me shqelm dhe grusht në fturë, pa pëlqimin e saj,-

- *me të cilën kreu veprën penale Sulmi nga neni 187 par.1 të KPRK-së.*

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 43, 46 dhe 73 të KPK-së dhe neneve 365 e 495 të KPPK-së i shqipton:

#### DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarin [REDACTED], i shqiptoi dënimin në shumën prej 200 € (dyqind Euro), të cilën shumë i akuzuari obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Nëse dënimini me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjtë do t'i shndërrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 €uro, do t'i llogaritet nga një (1) ditë burg.

E dëmtuara [REDACTED] nga Ferizaj, me vendbanim në rrugën [REDACTED], për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Obligohet i akuzuari të paguaj në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Obligohet i akuzuari të paguaj edhe taksën në shumën prej 30 €uro, konform nenit 39 parografi 3 nënparragaifi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimate të Krimtit.

#### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj- Departamenit i Përgjithshëm me aktakuzën PP/II.nr.323-1/18 të datës 05.02.2018, ka akuzuar [REDACTED] nga Ferizaj,,me vendbanim në rrugën [REDACTED], për veprën penale Sulmi nga neni 187 par.1 të KPRK-së, dhe në aktakuzë ka parashtruar kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor kundër të akuzuarit me arsyen se ka prova të besueshme që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i njëjtë.

Gjkata gjatë shqyrimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 parag.1, 2 dhe 3 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovin e kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor.

Nga provat materiale të bashkëngjitura në shkresat e lëndës dhe ate nga kallximi penal të paraqitur nga Policia e Kosovës-Stacioni Policon në Ferizaj, me numër të rastit 2017-CF-126, të datës 11.01.2017,,deklarata e të dëmtuarës [REDACTED], dhënë në polici me datën 17.01.2017,deklarata e dëshmitarit [REDACTED] dhënë në polici me datën 21.02.2017, ku gjykata ka konstatuar se këto prova janë të bazuara dhe bindëse, sepse vërtetojnë që i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së , [REDACTED], nga Ferizaj, me vendbanim në rrugën [REDACTED], për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike janë udhëzuar në kontest civil.


Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së dhe nenit 39 parag.1 nënpar. 3.1 të Ligjit për Kompenzimin e viktave të krimtit Nr.05/L-036.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL  
P.nr.236/2018 i dt.10.04.2017

Bashkëpun.prof.  
Mimoza Shabani

Gjyqtari  
Adem Shabani



**UDHËZIM JURIDIK:**

Kudër këtij aktgjykimi lejohet kundërshtimi në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të dërgesës së njëjtë, gjyqtarit të vetëm gjykues të kësaj gjykate, përmes kësaj gjykate. Pas skadimit të afatit të lejuar për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor bëhet i plotfuqishëm dhe ekzekutohet dënim i shqiptuar.